



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-076, për policinë, dispozitave të neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit administrativ nr. 27/2012, MPB-03/2012 MAPL, për këshillat komunalë për bashkësi, si dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2020, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT**  
**PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

**I**

**MIRATOHET** Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, nr. 01-020/04-0105364, dt. 04.05.2018.

**II**

Në pikën II të vendimit të cekur si në pikën I të këtij vendimi,

1. Në vend të Hateme Gashit, përfaqësuese e DSHPMSh-së, caktohet Edona Krasniqi, zyrtare në Sektorin e Kuvendit, Drejtorja e Administratës;
2. Caktohet anëtari i ri i Komitetit Lokal për Siguri Publike në lagjet " Arbëria – Tophane " nga Stacioni policor "Qendra", ku si përfaqësues i KLSP- së është caktuar Nysret Beka.

**III**

Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit nr. 01-020/04-0105364, dt. 04.05.2018.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, dhe pas publikimi në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-020/04-58471/20, më 11.03.2020

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

